



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:063942

Datë: 18.11.2024

Numri i dokumentit: 06479010

K.Dh.Sh.II.nr.1555/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Bajrami kryetar i kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Dren Rogova, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Komuna e Gjilanit, te cilën sipas autorizimit e përfaqëson Burim Maliqi, kundër të paditurës Kompania Kosovare per Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Diton Rexhepi jurist, me objekt kontesti kompensim demi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Ekonomike, KE.nr.2677/22, të datës 27.06.2024, me datë 18.11.2024, mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si të pabazuar ankesa e të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Gjilan, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Për Çështje Ekonomike, KE.nr.2677/22, të datës 27.06.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e Dhomës së shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka vendosur si në vijim;

I. **APROVOHET** ne pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Komuna e Gjilanit, dhe **DETYROHET** i padituri Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike **KEDS SH.A.** qe ne emër te kompensimit te demit si pasoje e zjarrit te shkaktuar me date 16.12.2015, ne shkollën fillore te mesme te ulet "Vatra e Diturisë" ne fshatin Livoç i Epërm, Komuna e Gjilanit, t'ia paguaj paditësit ne emër te demit si pasoje djegies së pajisjeve, shumën prej 805.00€ (tetëqind e pese euro) me kamate ligjore prej 8% duke llogaritur nga data e parashtrimit te padisë, respektivisht 19.10.2016 deri ne pagesën definitive te gjitha ne afat prej 7 (shtate) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

II. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiisë së paditësit Komuna e Gjilanit me te cilën ka kërkuar qe te detyrohet i padituri KEDS SH.A qe t'ia paguaj paditësit ne emër te demit si pasoje e djegies se 40 poçeve elektrik shumën prej 800.00€ (tetëqind euro).

III. Secila pale i barte shpenzimet e veta.

Kundër këtij aktgjykimi, pala e paditur, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes esenciale së dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit si e bazuar, ashtu që të prishet aktgjykimi i atakuar dhe çështja të kthehet në rivendosje apo te ndryshohet aktgjykimi i gjykatës se shkalles se parë dhe te refuzohet ne tërësi si e pa bazuar kërkesëpadiia e palës paditëse.

Pala paditëse nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale e ka shqyrtuar ankesën e paditësit dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të paditurës, shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës secilën veç e veç e edhe lidhshmërinë e tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti ankesa e e te paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi Komuna e Gjilanit, me datën 19.10.2016, pranë Gjykatës Themelore ne Gjilan, ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Gjilan, (derisa pas ankesës çështja është vendosur nga Gjykata Komerciale e Kosovës) me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura qe ne emër te kompensimit te demit te shkaktuar si pasoje e defekteve elektrike te paguaje prestimin obligator ne shumen prej 1,605.00 me kamate ligjore ne lartësi prej 8 % nga dita e paraqitjes se padisë deri ne nxjerrjen e vendimit përfundimtar, kurse gjate shqyrtimit gjyqësor, pala paditese, pas marrjes se provës me ekspertiza ka bere precizimin e kërkesëpadiisë ne kuptim objektiv, sa i përket lartësisë, duke precizuar shumen e kërkuar ne emër te kompensimit ne lartësinë prej 805.00

Pala paditëse ne pretendimet e paraqitura ne padi dhe gjate shqyrtimit gjyqësorë ka parashtuar se për shkak te prishjeve-avarisë e cila ka ndodhur ne shtyllën elektrike prej nga furnizohet shkolla SHFMU “Vatra e Diturisë” ne fshatin Livoç, ka ardhur deri tek shkaktimi i demit material ne disa pajisje shkollore si në Power Motherboard for Ricoh Afico MPC2500 në shumën prej 300.00€, demin e shkaktuar ne Roller Ricoh në shumën prej 100.00€, demin e shkaktuar ne Display Motherboard Rico në shumën prej 100.00€, demin e shkaktuar ne shtëpizën e kompjuterit, (Pc CoreiS-5400,8GBRAM,120HB SSD) në shumën prej 280.00€, demin e shkaktuar ne modem (Router TP-Link) në shumën prej 25.00€ dhe demin e shkaktuar ne 40 poçe elektrik shumën prej 800.00€, ne shume totale prej 1,605.00€.

Përfaqësuesi i te paditurës ne kundërshtimet e parashtuara ne përgjigje ne padi, si dhe kundërshtimet e bëra gjate shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se Komisioni Profesional i te paditurës me 16.12.2015 kanë dal ne vendin e ngjarjes ku kishin konstatuar se nga përcuesi i

neutral apo zero punuese, shkollës fillore i janë djegur fotokopjuesi, kompjuteri dhe një modem, mirëpo ne procesverbalin e hartuar nga Komisioni Profesional i KEDS nuk ishte vërtetuar se me fajin e KEDS janë djegur edhe 40 poçe elektrike ne shkollën fillore. Me tej ne parashtrime pala e paditur, ka theksuar se paditësi ne padi thirret veten ne procesverbalin e KEDS ndërsa nuk ka prezantuar asnjë prove material si foto dokumentacion përveç dy oferta te marra nga dy kompani për rastin i cili ka ndodhur ne 2015 ndërsa oferta e Pro Computers është lëshuar me datën 05.02.2016, derisa pala nuk ka sjell asnjë prove bindëse për ta vërtetuar lartësinë, si fatura te bashkangjitura dhe kuponin fiskal për ta vërtetuar lartësinë e demit. Po ashtu ka theksuar se çdo pajisje elektrike posedon mbrojtësin elektrik edhe pse këto pajisje te lartcekura nga energjia elektrike kane mundur te pësojnë ndonjë defekt apo djegie por ne asnjë mënyre nuk kane mundur te djegën ne tërësi, me tej ka kundërshtuar për faktin se duke u bazuar ne kodin e shpërndarjes te aprovuar nga ZRRE përgjegjësia e furnizuesit operatorit shtrihet deri tek njëtori elektrik pika matëse por jo edhe ne brendësi te shtëpisë, objektit ne instalimet e brendshme elektrike andaj pala e paditur i ka propozuar gjykatës qe padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit te refuzoj si te pa bazuar.

Gjykata e Dhomës së shkallës së parë pas administrimit të provave dhe atë Proces nr. 1161 i dt.26.01.2016; Kërkesës se drejtuar zyrës ligjore te Komunës së Gjilanit i dt. 14.10.2016; Ofertës lëshuar nga Eurodex për SHF. "Vatra e Diturisë"; Ofertës lëshuar nga Pro Computers me dt. 05.02.2016; Kontratës për furnizim me energji elektrike për konsumatorët jo-shtëpiak te dt. 16.12.2015; Vërejtjes e dt. 23.11.2026; Raportit të ekspertizës se elektros i hartuar nga eksperti Nagib Krasniqi dorëzuar ne Gjykatë me dt. 15.07.2020; Ekspertizës nga lëmia e makinerisë nga eksperti Bujar Huruglica e datës 08.05.2024; Dëshmisë se dëshmitarëve Muhamet Rama dhe Fadil Musliu te dhëne ne procesverbalin e dt. 04.03.2021; shikimin ne foto dokumentacion, si dhe pas dëgjimit te pretendimeve të palëve ndërgjyqës ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe te detyrohet e paditura, qe ne emër te kompensimit te demit si pasoje e zjarrit te shkaktuar me date 16.12.2015, ne shkollën fillore te mesme te ulet "Vatra e Diturisë" ne fshatin Livoç i Epërm, Komuna e Gjilanit, t'ia paguaj paditësit ne emër te demit si pasoje djegies së pajisjeve, shumën prej 805.00€ (tetëqind e pese euro) me kamate ligjore prej 8% duke llogaritur nga data e parashtrimit te padisë, respektivisht 19.10.2016 deri ne pagesën definitive te gjitha ne afat prej 7 (shtate) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, si dhe te refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit me te cilën ka kërkuar qe te detyrohet i padituri qe t'ia paguaj paditësit ne emër te demit si pasoje e djegies se 40 poçeve elektrik shumën prej 800.00€ (tetëqind euro).

Gjykata e shkalles se parë, vlerësoi se ne përputhje me nenin 136 par.2 te LMD-se, i padituri mban përgjegjësi për kompensimin e demit për faktin se demi i shkaktuar qëndron ne lidhje kauzale me veprimtarinë e te paditurit dhe se demi është shkaktuar si pasojë e rrymës elektrike, gjate furnizimit te rregullt te paditësit dhe duke marre për baze faktin se djegia e pajisjeve elektrike ka ndodhur ne procesin e furnizimit te paditësit me energji elektrike përkatësisht si pasoje e problemit me zeron ne shtyllën elektrike nga e cila është furnizuar me energji elektrike paditësi, e ky fakt është vërtetuar edhe nga prova e marre gjate zhvillimit te procedurës – mendimi dhe konstatimi i ekspertit te elektros si dhe për faktin se furnizimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike paraqet veprimtari te rrezikshme, andaj rrjedh se ne rastin

konkret kemi të bëjmë me përgjegjësini objektive për shkaktimin e demit. Gjykata vlerëson se në rastin konkret, përgjegjësia për demin e shkaktuar bie mbi të paditurin, sepse veprimtaria të cilën e ushtron i padituri kualifikohet si veprimtari me rrezik të shtuar, e cila dallon nga veprimtaritë tjera, gjatë ushtrimit të cilave nuk ekziston fare rrezik nga shkaktimi i demit. Vet fakti se veprimtaria e të paditurit përbën veprimtari të tillë, mbi të cilën nuk mund të ushtrohet kontroll i plote dhe gjate se cilës, në çdo moment dhe në çdo kohe, pa asnjë lëshim të asnjërës pale, mund të paraqitet rreziku dhe mund të shkaktohen aksidente me pasoja të rënda, e kualifikon veprimtarinë e të paditurit si veprimtari me rrezik të shtuar, e cila krijon përgjegjësi për të gjitha demet e shkaktuara që rezultojnë apo ndërlihen me energjinë elektrike, pavarësisht nga fajti (përgjegjësi objektive). Për më tepër gjykata e shkallës së parë vlerëson se i padituri, duke marr për bazë faktin se njëjta ushtron veprimtari me rrezik të shtuar ka qene e obliguar që të ndërmer të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e çfarëdo rrezikut që ven nga energjia elektrike përfshire këtu edhe rregullimin e zeros (përçuesit neutral) në shtyllën elektrike.

Prandaj, bazuar në nenin 154 të LMD-se, gjykata vlerëson se në veprimtarinë me rrezik të shtuar, rreziku dhe përgjegjësia supozohet andaj çdo dëm i pësuar nga këto veprimtari, bie në përgjegjësi të ushtruesit të veprimtarisë së tillë dhe se përgjegjësia e të paditurit për demin e shkaktuar mund të shmanget, vetëm nëse i padituri e provon se demin nuk ishte shkaktuar nga energjia elektrike, apo nëse përkundër faktit se ka marre të gjitha masat e duhura, demin nuk do të mund të mënjanohej në një mënyrë, respektivisht duhet ta provojë se dëmi ka ndodhur absolutisht pa fajin e tij dhe se nuk ka mundur ta parashoh dhe as ta parandalojë atë, si dhe të provojë se demin ka ndodhur ekskluzivisht me fajin dhe nga veprimet e paditësit e që në rastin konkret, nga vete procesverbali i hartuar nga zyrtarë të paditurit kanë konstatuar se përçuesi i neutral (zero punuese) nuk ka qene i shtrënguar mirë nga fare ka ardhur edhe deri tek shkaktimi i demit tek paditësi andaj në kuptim të nenit 155 të LMD-se, i padituri është përgjegjës për demin që ka pësuar paditësi. Rrjedhimisht gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe në dispozitat ligjore të cituara ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e palës paditëse ishte pjesërisht e bazuar duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Sa i përket lartësisë së kërkesëpadiës, gjykata vendosi duke u bazuar në ekspertizën e makinerisë së punuar nga eksperti Bujar Huruglica, ku është vërtetuar se vlera e demit të shkaktuar në pajisje është 805.00€, shuma këto të cilat sipas vlerësimit të gjykatës, gjejnë mbështetje në shkresat e lëndës. Gjykata vendosi duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit ashtu që i njohu kompensimin e demit e vetëm për pajisjet e dëmtuara të përcaktuara me procesverbalin nr.1161, të datës 26.01.2016, ndërsa refuzoj pjesët tjetër të kërkesëpadiës mbi shumën e aprovuar sa i përket demit të shkaktuar për 40 poçe elektrike për shkak se gjykata nuk gjeti prova të besueshme do vërteton faktin se të njëjtat janë dëmtuar si rezultat i problemit të ndodhur me datë 16.12.2015. Kurse për shpenzimet gjyqësore si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, vendosi sipas nenit 452 par. 2 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e

drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Dhoma e Shkallës së Dytë mbështet në tërësi konstatimet dhe shpjegimet lidhur me faktet dhe rrethanat vendimtare të cilat kanë sjell që të merret një aktgjykim për të aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, e që në mënyrë të thukët i ka dhënë Gjykata e Dhomës së Shkallës së Parë. Dhoma e Shkallës së Dytë po ashtu konstaton se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sepse gjykata ka administruar gjitha provat e propozuar, dhe i ka vlerësuar se cilën veç e veç edhe varshmërinë e tyre dhe ka gjetur se çështja faktike është vërtetuar drejtë dhe në bazë të kësaj çështje faktike drejtë janë aplikuar dispozitat ligjore, të cekura më hollësisht në aktgjykimin e kundërshtuar. Kështu që Gjykata e Shkallës së Parë, me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale ka marrë aktgjykimin me të cilën ra refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, si të pa bazuar.

Edhe kjo Gjykatë e Dhomës së Shkallës së Dytë e mbështet konstatimet dhe vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se në këtë çështje juridike nga provat e administruara është vërtetuar fakti se e i padituri mban përgjegjësi për kompensimin e demit për faktin se demi i shkaktuar qëndron në lidhje kauzale me veprimtarinë e të paditurit dhe se demi është shkaktuar si pasojë e rrymës elektrike, gjate furnizimit të rregullt të paditësit dhe duke marrë për bazë faktin se djegia e pajisjeve elektrike ka ndodhur në procesin e furnizimit të paditësit me energji elektrike përkatësisht si pasojë e problemit me zeron në shtyllën elektrike nga e cila është furnizuar me energji elektrike paditësi, e ky fakt është vërtetuar edhe nga prova e marrë gjate zhvillimit të procedurës – mendimi dhe konstatimi i ekspertit të elektos si dhe për faktin se furnizimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike paraqet veprimtari të rrezikshme, andaj rrjedh se në rastin konkret kemi të bëjmë me përgjegjësinë objektive për shkaktimin e demit. Derisa lartësi e demit është vërtetuar me ekspertize të makinerisë, ku është vërtetuar se vlera e demit të shkaktuar në pajisje është 805.00€, shuma këto të cilat sipas vlerësimit të gjykatës, gjejnë mbështetje në shkresat e lëndës

Nga një gjendje e tillë faktike e konstatuar dhe vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, rezulton se në rastin konkret është zbatuar drejt e drejta materiale, për shkak se nuk janë plotësuar kushtet ligjore që të aplikohen dispozitat e kompensimit të demit, me konkretisht nenin 136 par.2 të LMD-se, ku përcaktohet se "Për demin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i demit përgjigjet pavarësisht nga fajti" pra i padituri mban përgjegjësi për kompensimin e demit për faktin se demi i shkaktuar qëndron në lidhje kauzale me veprimtarinë e të paditurit dhe se demi është shkaktuar si pasojë e rrymës elektrike. Prandaj, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret, përgjegjësia për demin e shkaktuar bie mbi të paditurën, sepse veprimtaria të cilën e ushtron ajo kualifikohet si veprimtari me rrezik të shtuar, e cila dallon nga veprimtaritë tjera, gjate ushtrimit të cilave të cilave nuk ekziston fare rrezik nga shkaktimi i demit. Vet fakti se veprimtaria e paditësit përben veprimtari të tillë, mbi të cilën nuk mund të ushtrohet kontroll i plote, dhe gjate se cilës, në çdo moment dhe në çdo kohë, pa asnjë lëshim të asnjërës pale, mund të paraqitet rreziku dhe mund të shkaktohen aksidente me pasoja të rënda, e kualifikon veprimtarinë e të paditurës si veprimtari me rrezik të shtuar, e cila krijon përgjegjësi për të gjitha demet e shkaktuara që rezultojnë apo ndërlihen me rrymën elektrike, pavarësisht nga fajti (përgjegjësi objektive).

Ne veprimtarinë me rrezik të shtuar, rreziku dhe përgjegjësia supozohen andaj çdo dem i pësuar nga këto veprimtari, bie ne përgjegjësi të ushtruesit të veprimtarisë së tillë. Lidhur me këtë ne nenin 154 të LMD-se, përcaktohet se "Demi i lidhur me sendin e rrezikshëm, respektivisht me veprimtarinë e rrezikshme, konsiderohet se rrjedh nga ky send respektivisht nga kjo veprimtari (presumimi i kuazalitetit), me përjashtim në qofte se provohet se ato nuk kanë qene shkak i demit". Prandaj, bazuar në këtë dispozitë, përgjegjësia e të paditurës për demin e shkaktuar mund të largohet nga ajo, vetëm nëse e paditura e provon se demin nuk është shkaktuar nga rryma, apo nëse përkundër faktit se ajo i ka marrë të gjitha masat e duhura, demin nuk do të mund të mënjanohej në asnjë mënyrë, respektivisht duhet ta provojë se demin ka ndodhur absolutisht pa fajin e saj dhe se ajo nuk ka mundur ta parashohë dhe as ta parandalojë atë, si dhe të provojë se demin ka ndodhur ekskluzivisht me fajin dhe nga veprimet e paditësit. Meqenëse në rastin konkret e paditura nuk ka ofruar prova, me të cilën do të vërtetonte se ajo nuk është përgjegjëse për demin, duke aplikuar nenin 155, të LMD-se, i cili parasheh se, "Për demin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për demin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të", kjo gjykatë vlerëson se pretendimet ankimore të paditurës, lidhur me gjendjen faktike respektivisht shkakun e zjarrit, janë të pabazuara dhe se e paditura është përgjegjëse për demin e pësuar nga paditësi, pasi që me prova të nxjerra gjatë gjatë shqyrtimit gjyqësorë është vërtetuar se demin është shkaktuar si pasojë e rrymës elektrike, gjatë furnizimit të rregullt të paditësit dhe duke marrë për bazë faktin se djegia e pajisjeve elektrike ka ndodhur në procesin e furnizimit të paditësit me energji elektrike përkatësisht si pasojë e problemit me zeron në shtyllën elektrike nga e cila është furnizuar me energji elektrike paditësi

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e shkallës së dytë nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.1555/24 dt.18.11.2024

Kryetari i kolegjit,
Faton Bajrami